



Prishtinë: 12.10.2012

Kodi i ZRRE-së: V_478_2012

Nr. i Referencës: ZRRE/DMK_V_816_07_12

Bordi i Zyrës së Rregullatorit për Energji

Duke marrë parasysh:

1. Kompetencat e Zyrës së Rregullatorit për Energji të dhëna në nenin 14 të Ligjit për Rregullatorin e Energjisë;
2. Dispozitat sipas Kreut IV, nenit 17 dhe 18 të Rregullës për Zgjidhjen e Ankesave dhe Kontesteve në Sektorin e Energjisë;
3. Dëshmitë e paraqitura nga palët;
4. Vendimin e DMK të ZRRE-së: **ZRRE/DMK_V_816_07_12**; dhe
5. Ankesën e KEK-ut me datë 20.07.2012.

Në mbledhjen e mbajtur më 12 tetor 2012 nxori këtë:

VENDIM

- I **REFUZOHET** ankesa e KEK-ut ndaj vendimit të DMK-së për konsumatorin B. I. (shifra në KEK: DPR - 1232), nga Prishtina, si në arsyet e paraqitura në arsyetimin e këtij vendimi.
- II **MBETET në fuqi** vendimi i Departamentit për Mbrojtjen e Konsumatorëve nr. ZRRE/DMK_V_816_07_12 i datës 04.07.2012.

Arsyetim

Me datë 08.10.2008 konsumatori ka bërë kërkesë zyrtare në KEK për shlyerjen e borxhit nga fillimi deri në periudhën 01/2009. Gjithashtu konsumatori ka ofruar kontratën lidhur mes tij dhe Lj. J. vërtetuar në Gjykatën Komunale në Prishtinë me të cilën vërtetohet se z.B. I. nga Prishtina me numër letërnjoftimi 1012355285 nga data 11.01.2009 është pronar i vetëm legjitim.

Pas ankesës së konsumatorit parashtruar KEK-ut, me datë 15.09.2011 Departamenti për konsumator në KEK iu është përgjigjur konsumatorit duke bërë kontestimin e borxhit nga periudha 05/2007 deri më 10/2007 duke u thirrur në aktgjykimin e Gjykatës Komunale në Prishtinë P.nr. 1251/08 të datës 04.10.2009 dhe procesit të Policisë së Kosovës numër 2007/10/02851 datë 17.10.2007. Pas kësaj konsumatori brenda afatit ligjor ka apeluar përgjigjen e KEK-ut në DMK të ZRRE-së.

Departamenti për Mbrojtjen e Konsumatorëve në ZRRE ka bërë shqyrtimin e ankesës së konsumatorit dhe me datë 04.07.2012 ka nxjerr vendim duke **aprovuar** ankesën e konsumatorit dhe duke kërkuar nga KEK-u që shifrën e konsumatorit DPR – 1232 duhet ta liroi nga borxhi i akumuluar deri në periudhën 10/2007, gjithashtu KEK-sha, ka të drejtën që borxhin e krijuar në shifrën e konsumatorit DPR- 1232 deri në periudhën 10/2007 ta kërkojë përmes procedurës gjyqësore.

Pas marrjes së vendimit të DMK-së, me datë 25.07.2008 KEK-u ka parashtruar ankesë në Bordin e ZRRE-së ndaj këtij vendimi, me të cilën ka kundërshtuar në tërësi vendimin e DMK-së nr. **ZRRE/DMK_V_816_07_12** të datës 04.07.2012. Në ankesën e KEK thuhet se lidhur me këtë lëndë KEK e ka bërë ekzekutimin, si dhe pika tjetër është se KEK me vendimin e gjykatës e ka përfunduar lëndën



në muajin 10/2007. Gjithashtu KEK ka propozuar që të pranohet kundërshtimi si dhe borxhi të ngelet kontest deri në përfundimin e procedurave ligjore.

Bordi i ZRRE-së gjatë analizës së lëndës ka vërejtur se me datë 02.04.2012 konsumatori ka parashtruar kërkesë zyrtare në KEK për shlyerjen e borxhit të krijuar nga fillimi deri në periudhën 03/2009, si dhe është vërejtur se në KEK me datë 08.10.2008 nga konsumatori Lj. J. (J. L.) është parashtruar kërkesë zyrtare në KEK për shlyerjen e borxhit të krijuar nga fillimi deri në periudhën 10/2008 pasi që prona ka qenë e uzurpuar.

Parashtruesi i ankesës B. I. ka ofruar kontratë për shitblerje të banesës lidhur mes tij dhe Lj. J. me datë 11.01.2009, vërtetuar në Gjykatën Komunale në Prishtinë me të cilën vërtetohet se nga data 11.01.2009 B. I. është blerësi i vetëm përkatësisht pronar legjitim i pronës (banesës) e cila gjendet në Prishtinë me sipërfaqe 30.63m², në rrugën “Zona e hekurudhës”, Hyr 1, banesa nr.1.

Konsumatori B. I. ka ofruar vërtetimin si dhe vendimin e lëshuar nga AKP- Agjencioni Kosovar i Pronave me të cilin vërtetohet se me datë 27.06.2003 komisioni për kërkesa Pronësore Banesore ka marruar vendim me të cilin pronësia i kthehet parashtruesit të kërkesës Lj. J. si dhe ka vërtetuar se prona ka qenë e uzurpuar nga N. M. Në vërtetimin e lëshuar nga Agjencioni i Pronave me datë 27.12.2011 po ashtu vërtetohet se drejtoria për çështje pronësore dhe banesore me datë 10.11.2006 ka vendosur ta mbyll çështjen pasi nuk ka pasur asnjë kërkesë nga pala tjetër për rishqyrtimin e vendimit të komisionit si dhe për ekzekutimin e vendimit nga parashtruesi i kërkesës. Në vërtetimin e AKP-së të datës 27.12.2011 po ashtu theksohet se “pasi që nuk është bërë dëbimi fizik nga ky Agjencion po ashtu nuk mund të vërtetohet edhe periudha e saktë kur uzurpatori N. M. ka lëshuar pronën”.

Është analizuar edhe procesverbali i përpiluar nga Policia e Kosovës me datë 17.10.2007 në të cilin procesverbal theksohet se: me datë 17.10.2007 Policia e Kosovës ka pranuar një thirrje për të shkuar te ndërtesa C5 në Ulpianë. Sipas procesverbalit theksohet se policia e Kosovës ka marrë urdhër të bëjë largimin e një familje nga një banesë pasi nuk ishte pronë e saj. Pronarja e banesës Lj. J. i kishte dhen afat asaj familje që për njëzetekatër (24) orë të liroj banesën. Pasi kryefamiljari nuk ishte prezent policia kishte kontaktuar me R. K. dhe i kanë kërkuar ta liroj banesën. Pasi që të gjitha gjërat nuk arriti t'i largoj nga banesa policia e Kosovës kishte vendosur një shirit derës pasi që dera ishte dëmtuar dhe nuk mbyllej, pronarja e morri çelësin e banesës. Në mungesë të kryefamiljarit policia e Kosovës kishte marrë një deklaratë nga e shoqja në cilësinë e dyshueses ndërsa pronarja e kishte shkruar në gjuhën e saj deklaratën, pastaj kemi hapur rastin për shkak të dëmtimit të vulave zyrtare dhe se policia e Kosovës kishte kontaktuar me prokurorin i cili i kishte udhëzuar të shkohej në procedurë të rregullt gjyqësore.

Bordi i ZRRE-së në mbledhjen e mbajtur me datë 12 tetor 2012 ka analizuar të gjitha dëshmitë e paraqitura nga ana e KEK-ut. Pretendimet e KEK, të theksuara në ankesë nuk janë bindëse pasi që KEK-u ka kontestuar vetëm borxhin e krijuar nga uzurpatori për periudhën 05/2007 deri më 10/2007 në vlerë 518.06€, bazuar në vendimin e Gjykatës Komunale në Prishtinë P.nr.1251/08 të datës 04.10.2009 si dhe raportin e Policisë së Kosovës 2007 10 02851 të datës 17.10.2007, por që nuk ka marruar për bazë ankesën e konsumatorit për shlyerjen e borxhit për periudhën e më hershme pasi që prona bazuar në dokumentacionin e lëshuar nga AKP, prona ka qenë e uzurpuar.

Në Nenin 1 të Urdhëresës Administrative 2004/2 thuhet se: borxhi i krijuar nga posedues të kundërligjshëm të lokalit apo banesës nuk do t'i ngarkohet pronarit të ri të ligjshëm pas marrjes së vendimit nga Drejtorati për çështje pronësore dhe banesore apo nga komisioni i ankesave për çështje pronësore-banesore ose vendimit të gjykatës kompetente, në të cilin theksohet data e kthimit në



posedim të pronës pronarit të ligjshëm dhe me të cilin urdhëron nxjerrjen e poseduesit të kundërligjshëm.

Në Nenin 2 të Urdhëresës Administrative nr. 2008/5 theksohet: borxhi i krijuar i mëhershëm nga persona që e kanë shfrytëzuar banesën në formë jo-legale ose gjatë periudhës së shfrytëzimit legjitim nga ndonjë person ndryshe nga bartësi legal i pronës sipas skemës qiradhënëse të Agjencionit Kosovar për Prona, ky borxh nuk do t'i ngarkohet personit i cili është përcaktuar si pronar i ligjshëm nga Agjensioni Kosovar për Prona.

Mbështetur nga të gjitha ato që u theksuan më lartë konsiderojmë se dokumentet e lëshuara nga Agjencia Kosovare e Pronës me të cilën vërteton gjithë rrjedhën e kësaj prone se kush e ka pasur në shfrytëzim (uzurpim), gjithashtu bazuar edhe në kontratë e shitblerjes të ofruar nga konsumatori Bejtush Isufi e cila është e vërtetuar edhe në gjykatën komunale, vijmë në përfundim se ky konsumator duhet të lirohet nga borxhi i shkaktuar nga ana e uzurpatorëve dhe se ky borxh të kërkohe në procedurë gjyqësore.

Bordi i ZRRE-së ka vlerësuar se KEK në ankesën e tij nuk ka prezantuar asnjë provë të vetme me të cilën e vërteton faktin se vendimi i DMK-së nuk është vendim i drejtë dhe i bazuar në ligj, gjithashtu ankesa e KEK-ut, nuk i përmban elementet bazë të një ankese, pasi që është shumë e mangët për kah përmbajtja. Kundërshtimet që janë dhënë në ankesë nuk i referohen se cilat dispozita ligjore janë shkelë nga ana e DMK-së, gjatë nxjerrjes së vendimit, por që KEK vetëm është thirr në formën e përgjithësuar pa konkretizuar decidivisht se ku janë bërë shkeljet gjatë nxjerrjes së këtij vendimi

Bordi i ZRRE-së në mbledhjen e mbajtur me datë 12.10.2012 ka analizuar ankesën e KEK-ut dhe vendimin e nxjerrë nga ana e DMK-së nr. ZRRE/DMK_V_816_07_12, dhe pas analizimit të hollësishëm të të gjitha dëshmime tjera të prezantuara në shkresat e lëndës ka vendosur si në dispozitivin e këtij vendimi.

Këshillë Juridike: Pala e pakënaqur me këtë Vendim mund të iniciojë konflikt administrativ në Gjykatën Kompetente, brenda tridhjetë (30) ditëve nga data e pranimit të Vendimit ose data e publikimit të tij në faqen elektronike të ZRRE-së, cilado që ndodhë e fundit.

Bordi i ZRRE-së

Enver Halimi, kryesues

Përparim Kabashi, anëtar

Blerim Koci, anëtar

Merita Kostari, anëtare

Krenar Bujupi, anëtar